



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6139 Prot

Lezhë, më 20 / 04 /2022

VENDIM


Nr. 38, Datë 19 . 04 .2022

“PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË BANIMIT PËR SUBJEKTET PËRFITUESE NË NDËRTESEN (PALLAT) TË RINDËRTUAR PAS “TËRMETIT TË 26- NËNTORIT” NË LAGJEN “SKËNDERBEG”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2 , nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d ", nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “ Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 "Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013, Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI :

1. Përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet që do të akomodohen në njësitë e reja të banimit në ndërtesën e re të ndërtuar nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, në Lagjen “Skënderbeg”, (ish ndërtesa nr.88), të shpallur si subjekte përfitues me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi dhe Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.27, datë 23.03.2022 “Për miratimin e listës së



subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ



LIDHJA NR.1

Bashkia Lezhë
Lagjja "Skenderbeg"

LISTA E SUBJEKTEVE DHE STRUKTURA E BANIMIT QE PERFITOJNE NE PALLATIN E RINDERTUAR NE LAGJEN "SKENDERBEG"

Nr.	Emer Atësi Mbiemer	Numri I Identitetit	Struktura e banimit që përfiton
1	D B D		1+1
2	F L R		1+1
3	N R B		1+1
4	Sh Q H		1+1
5	Xh O D		1+1
6	B A D		1+1
7	H F Z		1+1
8	B H Z		1+1
9	P A K		1+1
SUBJEKT QE PERFITON DY NJESI BANIMI ME STRUKTURE 1+1 PER SHKAK TE NUMRIT TE ANETAREVE TE FAMILJES			
10	M H S		1+1
			1+1

KRYETARI
Pjerin Ndreu

